

L I G J
Nr.9085, datë 19.6.2003

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.3.1995 "KODI I
PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 e pika 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7905, datë, 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pika 3 e nenit 14 ndryshohet si më poshtë:

"3. Gjykatat e apelit për krimet e rënda shqyrtojnë në shkallë të dytë, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, çështjet e gjykuara nga gjykata e krimeve të rënda.".

Neni 2

Pika 1 e nenit 187 ndryshohet si më poshtë:

"1. Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes.".

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 209, pas fjalës "letra" shtohen fjalët "letra me vlerë".

Neni 4

Në nenin 210, pas fjalës "tjetër" shtohen fjalët "edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë".

Neni 5

Pika 2 e nenit 274 ndryshohet si më poshtë:

"2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.".

Neni 6

Pika 3 e nenit 424 ndryshohet si më poshtë:

"3. Për ankimin e bërë kundër vendimeve të gjykatës për krimet e rënda vendos gjykata e apelit për krimet e rënda.".

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3890, datë 10.7.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu